



This project is financed
by the European Union



NORWEGIAN
HELSINKI COMMITTEE



NETHERLANDS
HELSINKI
COMMITTEE



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



Helsinki odbor za Balkan
grupa u Srbiji



TOGETHER FOR LIFE

Shoqëria civile kundër ekstremizmit të dhunshëm

"Kjo broshurë u realizua në kuadër të projektit "Shoqëria Civile kundër Ekstremizmit të Dhunshëm", financuar nga Bashkimi Europian. Përmblajtja e saj është përgjegjësi e plotë e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk reflekton domosdoshmërisht qëndrimin zyrtar të Bashkimit Europian."

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT


Promotor për ndërgjegjësimin publik për
parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm
në të gjithë vendin

NJË VËSHTRIM MBI SHIFRA:



31 ORGANIZATA JO FITIMPRURESE

Të shpërndara në 20 zona të vendit
punuan në terren me komunitetet për
promovimin e tolerancës





114 TRAJNIME NË TOTAL

U organizuan në zonat e prekura
nga projekti



13 FORUME TË HAPURA

Për të diskutuar rreth ekstremizmit të dhunshëm u
organizuan me pjesëmarrës të fushave të ndryshme:
Studentë, përfaqësues nga sistemi arsimor,
institucionet fetare, kulturore, ekonomike.





705 PYETËSORË U PLOTËSUAN

Për të nxjerrë të dhëna lidhur me ndjeshmërinë e komunitetit ndaj ekstremizmit të dhunshëm



NJË PROTOKOLL I HARTUAR

Për unifikimin e praktikave për Menaxhimin dhe Parandalimin e Radikalizmit që Çon në Ekstremizëm të Dhunshëm në burgje





10 TRAJNIME ME STAFIN E BURGJEVE



Për rritjen e njohurive të tyre për këtë fenomen



220 PUNONJËS TË BURGJEVE



U trajnuan se si të menaxhojnë rastet
potenciale të shfaqjes së ekstremizmit
të dhunshëm në këto institucione



48 PJESËMARRJE NË EMISIONE TELEVIZIVE DHE RADIOFONIKE

U realizuan për të folur për çështjen e ekstremizmit
të dhunshëm dhe sfidat e hasura në Shqipëri



6 UNIVERSITETE U PREKËN NGA KY PROJEKT

1. Universiteti "Fan Noli, Korçë";
2. Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër;
3. Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale;
4. Universiteti i "Eqerem Çabej" Gjirokastrë;
5. Universiteti European i Tiranës;
6. Universiteti Aleksander Moisiu, Durrës.





64 SHKOLLA U AKSESUAN NGA AKTIVITETE TË NDRYSHME NDËRGJEGJËSUESE




1. Shkolla Teknike Pyjore "Kolë Margjini", 2. Shkolla jopublike "Hasan Riza Pasha", 3. Shkolla e Mesme e Bashkuar, "At Gjon Karma" Gur i Zi, 4. Gjmnazi "Adem Haxhi" Postribë, 5. Gjmnazi "Ndre Mjeda" Bushat, 6. Gjmnazi "28-Nentori" 7. Gjmnazi "Shejnaze Juka", 8. Gjmnazi "Kol Idromeno", 9. Gjmnazi "At Luciano Agustini", 10. Gjmnazi "Oblikë", 11. Shkolla e Mesme e Bashkuar "Hot", 12. Gjmnazi "Nene Tereza" Bushat 13. Shkolla e Mesme e Bashkuar "Dëshmorët e Pojskës", 14. Gjmnazi "14 Engjejt, Bucimas 15. Gjmnazi "Qemal Bazelli", Pogradec, 16. Shkolla 9-vjeçare "3 Dëshmorët", Korçë 17. Shkolla "Selim Gjona", Pogradec; 18. Shkolla jopublike Thimi Marko; 19. Shkolla Profesionale TIK Fan S. Noli Korçe; 20. Shkolla e Bashkuar "Nesim Kacani" Devoll; 21. Gjmnazi "Fuat Babani", Bilisht; 22. Gjmnazi "Gjergj Pekmezi", Pogradec; 23. Gjmnazi "Muharrem Çollaku", Pogradec; 24. Shkolla 9-vjeçare "Dhimiter Gjata" Rrembec; 25. Shkolla e Mesme Maliq 26. Gjmnazi "Themistokli Gërmenji" Korçë; 27. Shkolla Pedagogjike "Petro Nini Luarasi"; 28. Gjmnazi "Raqi Qirinxhi"; 29. Gjmnazi "Bardhyl Pojani"; 30. Shkolla e Mesme "Jani Vreto" Leskovik; 31. Shkolla e mesme "Adem Vrapit" Roskovec; 32. Shkolla "Didin Bishani" Kurjan; 33. Shkolla 9-vjeçare "7 Dëshmorët" Strum, Fier; 34. Shkolla e mesme "Bajram Abdiu", Bicaj – Kukes; 35. Shkolla "Elmaz Ademi", Terthorë – Kukës; 36. Shkolla e mesme "Skënderbeu", Krumë – Has; 37. Shkolla 9 vjeçare "Migjeni" Puke; 38. Gjmnazi "Sabah Sinani" Puke; 39. Shkolla e mesme Fushë Arrëz; 40. Shkolla e mesme Gjegan; 41. Shkolla e mesme Gojan; 42. Shkolla e mesme Qelez; 43. Shkolla e Mesme Teknologjike "Hamdi Bushati" Shkodër; 44. Shkolle e Mesme Teknike "Arben Broci" Shkodër; 45. Shkolla e Mesme Profesionale Bushat; 46. Shkolla e Mesme "Karl Gega" Balldren; 47. Shkolla e Mesme "Pjetër Zarishti" Blinisht; 48. Gjmnazi Rrëshen; 49. Gjmnazi "Hydajet Lezha"; 50. Shkolla e Mesme Kolë Idromeno" Shkodër; 51. Gjmnazi Gruemirë; 52. Shkolla "Asim Vokshi" Tropojë; 53. Shkolla e Mesme "Havzi Nela" Kukës ; 54. Shkolla e Mesme Reps, Mirditë; 55. Shkolla e Mesme Ishull Lezhë; 56. Gjmnazi Pukë; 57. Gjmnazi Fushë- Arrëz; 58. Shkolla e Mesme Tamarë; 59. Shkolla e Mesme, Koplik; 60. Shkolla e Mesme Bajzë Kastrat; 61. Shkolla e Mesme e Bashkuar "Elmaz Ademi"; 62. Shkolla 9-vjeçare Bicaj; 63. Shkolla e Mesme "Qazim Shehu" Shtiqen; 64. Shkolla e mesme "Hoxha Tasim"



23 QYTETE DHE 30 FSHATRAT NË RANG VENDI U MBULUAN NGA KY PROJEKT

Qytetet: 1. Ura Vajgurore; 2. Peshkopi; 3. Cërrik; 4. Elbasan; 5. Shkodër; 6. Pogradec;
7. Korçë; 8. Maliq; 9. Bilisht; 10. Librazhd; 11. Kukës; 12. Durrës; 13. Has; 14. Ersekë;
15. Leskovik; 16. Roskovec; 17. Krumë; 18. Pukë; 19. Lezhë; 20. Gjirokastër;
21. Sarandë; 22. Fier; 23. Fushë-Krujë.

Fshatrat: 1. Gostimë, 2. Shtërmën, 3. Shals, 4. Bicaj, 5. Shtiqen, 6. Bardhoc, 7. Fshati Majtare,
8. Qendër Nj. A. Maqellarë, 9. Vau Dejës, 10. Hot, 11. Bushat 12. Oblike 13. Gruemire
14. Udenisht, 15. Bucimas, 16. Cerravë, 14. Trebinje, 18. Proptisht, 19. Rrëmbec, 20. Pojan,
21. Libonik, 22. Miras, 23. Vithkuq, 24. Dragostunjë, 25. Fshati Pojan, 26. Kurjan Strum,
27. Terthorë, 28. Fush-Arrëz, 29. Gjegjan, 30. Qelëz





11.409 PERSONA MORËN PJESË DREJTPËRDREJTË

Në aktivitetet e këtij projekti duke rritur kështu njohuritë
për fenomenin e ekstremizmit dhe radikalizmit



RRETH 500.000 PERSONA

Në mënyre jo të drejtpërdrejtë janë
prekur nga aktivitetet ndërgjegjëse
online të këtij projekti



NJË VËSHTRIM I SHKURTËR MBI VEPRIMTARITË E DISA ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE, PËRFITUESE TË SKEMËS SË NËN-GRANTIMIT.

NJË KARAVAN PER SFIDAT SOCIALE! NJË KARAVAN PER FUQIZIMIN TUAJ!

Shoqata Open Doors ka trajnuar për herë të parë 15 mësues dhe ka krijuar një grup të përbërë prej mësuesish dhe drejtorë shkollash për të trajnuar më pas rreth 120 mësues të tjerë rreth çështjeve të ekstremizmit në Bashkinë e Cërrikut, e konsideruar si një nga zonat me rrezik të lartë lidhur me radikalizmin që çon drejt ekstremizmit në qarkun e Elbasanit. Ky trajnim është shoqëruar me një fushatë informuese gjatë së cilës, stafi i organizatës ka udhëtuar me një mikrobus (të branduar me mesazhe, logo dhe imazhe sensibilizuese) drejt 7 shkollave të Cërrikut, zonës më problematike të qarkut të Elbasanit, duke dhënë informacion dhe duke shpërndarë materiale informuese si fletëpalosje dhe postera.

Luftëtarët e kthyer nga zonat e konflikteve, varfëria ekstreme dhe zbrazëtia e mjedisit nga pikëpamja kulturore, kohezioni social i brishtë në një komunitet të izoluar, janë faktorë që u vlerësuan se rrisin riskun e influencës së radikalizmit e ekstremizmit mes popullsisë së kësaj zone, në mënyrë të veçantë tek të rinjtë.

RRJETI PËR PARANDALIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

Shoqata “Gruaja ne Zhvillim” në Korçë për të rritur ndërgjegjësimin e të rinjve rreth çështjeve të ekstremizmit ka ftuar vetë të rinjtë për të kontribuar. Në kuadër të projektit “Rrjeti VEP për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm”, 120 të rinj nga shkollat e mesme në Korçë, Ersekë, Pojan, studentë, të rinj nga komuniteti rom dhe egjiptianë u përfshinë në realizimin e 6 vademekumeve, mbi të cilat u mbështet realizimi i një vademekumi final mbi konceptet bazë të ekstremizmit të dhunshëm. Mbështetja e mësuesve të tyre gjatë gjithë procesit dhe sesioneve orientuese i ndihmoi ata të zhvillojnë mendimin kritik mbi fenomenin që më parë ishte tabu, por gradualisht u vu në qendër të mendimeve të tyre. Gjatë këtij rrugëtimi, ata u përballën me diskutime mes njëri-tjetrit mbi tema të

cilat i kishin të panjohura më parë. Gjatë këtij procesi një nga të rinjtë u shpreh: “Ne shpjegojmë se ISIS nuk ka të bëjë fare me fenë - vazhdon ai - por me vullnetin për të shfrytëzuar një fe për kryerjen e akteve të dhunës.” Gjatë punës për hartimin e vademekumeve, të rinjtë u ndërgjegjësuam rreth ekstremizmit fetar, çështjeve të besimit dhe mësuan se ekstremizmi shpesh ka çuar popujt në dhunë dhe luftëra gjatë shekujve. Gjithashtu, nëpërmjet shpërndarjes së vademekumeve, ata mundën të kontribuojnë në ndërgjegjësimin e bashkëmoshatarëve të tyre dhe komuniteteve ku ata bëjnë pjesë për rëndësinë e parandalimit të këtij fenomeni që të mos bien pre e grupeve ose rrjeteve ekstremiste.ekstremizmit mes popullsisë së kësaj zone, në mënyrë të veçantë tek të rinjtë.

TË RINJTË PËR PAQE DHE DIALOG

Shoqata “Une, Gruaja”, Pogradec në partneritet me Qendrën “QKSCSH”, në kuadër të projektit “Të rinjtë për paqe dhe dialog” synoi të rrisë ndërgjegjësimin dhe fuqizimin e 360 të rinjve të arsimit të mesëm në zonat e largëta të Pogradecit (Trebijnë, Çerravë, Buçimas, Hudenisht, Proptisht) rreth fenomenit të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm nëpërmjet përfshirjes së tyre në aktivitete të përbashkëta edukative dhe kreative.

Gjatë pesë seminareve me temë: “Krijimi i kulturës dhe aftësive për zgjidhjen paqësore të konflikteve midis të rinjve” u shpërndanë materiale informuese dhe metodologjia e trajnimit iu përshtat me kërkesat e kësaj grup moshe. Gjithashtu të rinjtë krijuan klubet e debatit në secilën shkollë për të diskutuar rreth fenomenit të radikalizmit, ekstremizmit të dhunshëm, ngacmimit, dhunës verbale, menaxhimit të konfliktit, dhe përjashtimin social të të rinjve. Krahas përgatitjes së eseve, artikujve, fotove nxënësit e shkollave të mesme zhvilluan një fushatë online kundër radikalizimit të dhunshëm duke përdorur mediat sociale dhe Platformën e Ndërgjegjësimit të Radikalizimit www.qkscsh.org/nkr.

Qasja inovative ndaj fenomenit konsistoi gjithashtu në ushtrimet kreative dhe praktike lidhur me zgjidhjen e konflikteve, duke u bazuar në leximin e pjesëve nga “Babeli”, një roman për terrorizmin.


Sot, nxënësit e shkollave të mesme vazhdojnë të organizojnë klubet e debatit dhe të përgatisin ese mbi kulturën e paqes.



IMPAKTI NDËRGJEGJËSUES I PROJEKTIT

Në zonat e zbatimit në një shkallë nga 1 në 10
rezulton të jetë 8!

BETEJA E SHOQERISË CIVILE
ME EKSTREMIZMIN E DHUNSHËM
VIJON...



BASHKOHU ME NE!